



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Nr. 353-29631 më 09.06.2015



Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Nexhat Demaku

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 04.06.2015



- 1 .Vendim për caktimin e lokacionit për deponi të mbeturinave inerte
2. Vendimi për aprovimin e rishikimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2015
3. Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 353-29533 dt 08.06 2014

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturinat dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.04.06.2015 mori këtë:

VENDIM

- I. **CAKTOHET LOKACIONI** për deponin e mbeturinave inerte nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në territorin e Komunës së Glllogocit, caktohet në zonen kadastrale:
 - Komoran në pjesën e parcelës 1264-0 e evidentuar në njësinë P-70314035-01264-0, në vendin e quajtur “Rudishte”, me kulturë :kullosë klasa -6 , pronë komunale në sipërfaqe prej: S= 1.50,00 ha.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet, Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë ta bëjë ndarjen fizike në teren, dhe ta regjistroj në kadastër (RDPP) dhe ndërsa menaxhimin e këtyre deponimeve do ta benë Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë i Komunës së Glllogocit në kuptim të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Glllogocit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Glllogocit ndërsa monitorimin e zbatimit të tij e bënë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjeshmerise nga MAPL-së, dhe publikimit në ëebfaqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-29310 dt 05.06 2015

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës në mbledhje e mbajtur me dt: 04.06.2015 mori këtë

VENDIM
PËR RISHIKIMIT TË BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2015

Neni 1.

Me këtë vendim miratohet , rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2015.

Neni 2.

Buxheti i Komunës,rishikohet dhe ndryshohet të këto programe-nënprograme buxhetore të përcaktuara në nenin 3,4 dhe 5 të këtij Vendimi

Neni 3.

Ndryshimi i buxhetit me rishikim bëhet të shpenzimet kapitale, në (fondin 10) të këto programe nënprograme:

I.Të Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale; nënprogrami për Shërbimet e Shëndetësisë Primare (kodi i prog.730/73100) të kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale bëhet ky ndryshim:

-Projektit; Autoambulanca kodi i projektit nr.89107 shumës prej:47,445€ i zbritet shuma:8,600€.

Shuma e zbritur prej:8,600€ transferohet në projekt të ri kapital"Digjitalizimi i QKMF-së.

II.Të Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport: nënprogrami Shërbimet kulturore (kodi i Programit 850/85001) të kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale bëhet ky ndryshim:

-Projekt;Ndërtimi i Aneksit ndihmës në palestrën sportive me(kod nr.40050)anulohet në tërësi dhe shuma e mjeteve të projektit prej:10,000€ miratohet për projekt të ri "Rregullimi i parkingut në palestrën sportive ".

III.Drejtorati për Administratë dhe Personel; kodi i (programit 163001) të kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale bëhet ky ndryshim:

-Projekt Kapital "Orendit" (kodi i projektit 89003) anulohet dhe mjetet e këtij projekti në shumë prej:10,000€,miratohet për projekt të ri "Pajisje Sinjalizuese për QSHQ, GJC, Qëndrën One Stop dhe Severum.

IV.Drejtorati për Planifikim Hapsinor dhe Urbanizëm (kodi i programit 66310) të kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale bëhet ky ndryshim:

-Mjetët e mbetura nga këto projekte sipas këtyre shumave:

1. Infrastruktura në lagjën Halilaj Terdevc (kodi i projektit 89073) shuma prej:.....4,102€

- 2.Ndërtimi i kanalizimi në fshatin Terdevcë faza II.(kodi i projektit 40037) shuma prej:5,113€
- 3.Kanalizimi i ujërave të fshatit Dobroshevc lagja Shehu,,Caraku,Prenku dhe Xhota (kodi i projektit 40014) shuma prej:.....1,068€
- 4.Kanalizimi i ujërave të zeza në Kizharekë (kodi i projektit 89075) shuma prej:.....1,470€
- 5.Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Zabel i Epërm (kodi i projektit 40047) shuma prej:.....3,789€
- 6.Kanalizimi ujërave të zeza në Shtuticë (kodi i projektit 89089) shuma prej:.....20,000€
- 7.Kanalizimi i ujërave të zeza në Verbovcë lagja Kastrati dhe Prokshi(kodi i projektit 40011) shuma prej:.....20,000€
- 8.Kanalizimi i ujërave të zeza Krajkovë (kodi i projektit 89068) shuma prej:.....5,018€
- 9.Blerja e Veturës për zyrën e Kuvendit(kodi i projektit 40046) shuma prej:.....15,000€
- 10.Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Bytyq (kodi i projektit 89044) shuma prej:14,100€
- 11.Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Fatos (kodi i projektit 89070) shuma prej:15,666€
- 12.Kanalizimi i ujërave të zeza në Llapushnik (kodi i projektit40024) shuma prej:.....7,600€
- Gjithsej mbetjet e mjeteve nga projektet kapitale në shumë prej:.....112,926€**

Shuma e mbetur prej: 112,926€ nga projekte kapitale miratohet që të shpenzohet në këto projekte:

- 1.Asfaltimi i Rugës Lagja Bogqi LLapushnik(kodi i projektit89064) shuma prej:.....15,850€
- 2.Asfa.mi i rrugës Arllat Lagja e Xhamisë deri të Foniqt(kod i proj.89047) shuma prej:33,070€
- 3.Kanal. i ujërave të zeza fshatin TerstenikuDvorani, Kacurreti Goshani I (kodi i projektit 89043) shuma prej:.....9,684€
- 4.Hartimi i projekteve zbatuese për nevojat e komunës (kodi i projektit 40041) shuma prej:.....20,000€
- 5.Furnizimi me pjisje dhe orendi për objektin e ri të adminis. kom. projekt i ri.....9,337€
- 6.Nxemja Qendrore për SHFMU "Rasim Keqin" projekt i ri shuma prej:.....14,985€
- 7.Krijimi i databazës dhe inqizimi i kanaliz. dhe ujësjell. projekt i ri shuma prej:.....10,000€
- Gjithsej mjetët për Shpenzime për projekte kapitale në shumë prej:.....112,926€**

Neni 4.

Ndryshimi i buxhetit me rishikim bëhet të pagat dhe mëditjet në (fondin 10) të këto programe:

Të Zyra e Kryetarit (kodi i prog.16001) të kategoria ekonomike e shpenzimeve paga dhe mëditje zbritët shuma prej 300€ dhe e njehta shumë bartët të programi buxhetor Drejtorati për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik në paga dhe mëditje, (kodi i Programit 47001).

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, dhe për aplikimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-29541 dt 08.06 2014

Duke u bazuar ne nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Glllogocit Kuvendi Komunës ne mbledhjen e mbajtur me dt.04.06.2015 mori këtë:

VENDIM

Për plotësimin dhe ndryshimin e pikes 6 nënpika 6.8 të rregullores komunale nr.01-031-9313 të dt.17.11.2010

I.Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i tarifës komunale Pika 6 nenpika 6.8 e rregullores komunale që ka të bëjë për taksa,ngarkesa dhe gjoba komunale për dhënjën ne shfrytëzim të pronës komunale e në këtë rast shrytëzimin e hapsirave publike para lokaleve qe shfrytëzohën nga bizneset për terasa verore ku tarifat mujore sipas zonave janë:

Zona I-rë.....1.50€/m² ,
Zona II-të.....1.00€/m² ,
Zona III-të.....0.75€/m²

II.për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim urban dhe Drejtorati per inspekcion Komuna e Drenasit

III.Ky vendim hynë ne fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmerisë nga ana e MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj